REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LUSHNJË

Nr 6966 Prot

Lushnjë më 14/07/2026

RELACION

''MBI MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIT VENDOR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE TË BASHKISË LUSHNJË„

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltare/ këshilltarë!

Ky relacion paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak të Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Lushnjë. Qëllimi i këtij plani është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm, efikas dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e mbetjeve urbane, duke garantuar mbrojtjen e mjedisit, shëndetit publik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Hartimi dhe miratimi i këtij dokumenti mbështetet në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr. 57, date 16.10.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", VKM Nr. 286, datë 17.04.2026 "Për miratimin e Programit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve, Aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji,Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe dokumentet përkatëse sektoriale, Legjislacionin kombëtar dhe angazhimet për përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian.

Plani Vendor është hartuar për të:

- analizuar gjendjen aktuale të menax imit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Lushnjë;
- identifikuar problematikat dhe nevo at për përmirësim;
- përcaktuar objektivat strategjikë dh masat konkrete për menaxhimin e mbetjeve;
- rritur nivelin e riciklimit dhe redukt ar depozitimin e mbetjeve;
- përmirësuar shërbimin e grumbullir it, transportit dhe trajtimit të mbetjeve;
- siguruar përdorimin efikas të burim ve financiare dhe institucionale.

Dokumenti përfshin:

- analizën e situatës ekzistuese;
- parashikimin e sasisë së mbetjeve p r periudhën e planifikimit;
- objektivat dhe treguesit e performa ës;
- masat prioritare për përmirësimin e istemit të menaxhimit të mbetjeve;
- planin e investimeve dhe burimet e inancimit;

- mekanizmat e monitorimit dhe raportimit të zbatimit të planit.

Zbatimi i Planit Vendor do të realizohet në përputhje me programet buxhetore të Bashkisë Lushnjë, si dhe nëpërmjet fondeve të buxhetit vendor, transfertave nga buxheti i shtetit, programeve të donatorëve dhe burimeve të tjera të ligjshme financimi. Investimet do të planifikohen sipas prioriteteve dhe mundësive financiare të bashkisë. Miratimi i Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve përbën një hap të rëndësishëm për zhvillimin e një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të administrimit të mbetjeve në Bashkinë Lushnjë. Zbatimi i tij do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e shërbimeve publike dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak të miratojë **Dokumentin e Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Lushnjë**.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Adresa: Lagjia Kongresi Lushnje **Tel:+355 35 22139** **E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr 6966 Prot.

Lushnjë, më 14/07/2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 66 DATË 14/07/2026

" PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIT VENDOR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË LUSHNJË "

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë " Mbi miratimin e dokumentit të planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Bashkinë Lushnjë", në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja " b ", neni 23 pika 10 të Ligjit nr. 139/2015, " Për vetëqeverisjen vendore ", i ndryshuar. Nen 18, neni 20/2, neni 24, neni 65 të ligjit nr.57/2025 " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve ". VKM-së nr.286 datë 17.04.2026 " Për miratimin e Programit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve" .Ju:

PROPOZOJMË

1. Të miratojë dokumentin e " Plani Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Bashkia Lushnjë".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit, Bashkia Lushnje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri Hida

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT
Ariola Beqo

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJË

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+35 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com